



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 18.02.2025

Nr: 109

Ora: 12: 00

VENDIM

PËR

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË DENONCIMIN NR.17 ID, DATË 17.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË KONSOLIDUARA/KRIIK

Sot më datë 18.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

SUBJEKT: Zj. Luneda Sufali
Inspektorati Shtetëror Shëndetësor

Zj. Eugena Tomini
Drejtor i Përgjithshëm, Instituti i Shëndetit Publik

Zj. Jeta Deda
Drejtor i Përgjithshëm, Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor

Zj. Florida Dobi
Drejtor, Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët

OBJEKT: Përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të sloganeve/hashtag-eve partiakë/elektoralë

BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator



KONSTATOJ:

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 17.02.2025, ka paraqitur denoncim në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail.

Denoncimi është regjistruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 17 ID, në datën 17.02.2025.

Në këtë denoncim KRIIK parashtron sa vijon:

“Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, në faqet zyrtare në “Facebook” të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale janë duke u përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve. Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare e Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si:

- *Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;*
- *Instituti i Shëndetit Publik;*
- *Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;*
- *Qendra Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët.”*

Nga sa më sipër çmohet se, ekzistojnë kushtet për t'u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

VENDOS:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:
 - Zj. Luneda Sufali, Inspektorati Shtetëror Shëndetësor;
 - Zj. Eugena Tomini, Drejtor i Përgjithshëm i Institutit të Shëndetit Publik;
 - Zj. Jeta Deda, Drejtor i Përgjithshëm i Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor;
 - Zj. Florida Dobi, Drejtor i Qendrës Kombëtare Terapeutike dhe Rehabilituese për Fëmijët.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI